



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GRAMSH
DREJTORIA E SHËRBIMEVE ME
SIPËRMARRJE, TRANSPORTEVE, STREHIMIT DHE EMERGJENCAVE CIVILE

Nr 224/1 prot.

Gramsh, më 27/01/2022

Lënda : Kthim-përgjigje kërkesës Nr.224 Prot, datë 18.01.2022

Drejtuar: Znj. ALBINA HOXHA
Rruga "Pjetër Budi" 69 Tiranë

Në përgjigje të kërkesës suaj Nr.224 prot., date 18.01.2022 në të cilën kërkon informacion nga bashkia jonë mbi zbatimin e ligjit nr.22/2018 "Për strehimin Social" ju bëjmë me dije se: Në bashkinë e Gramshit janë 442 familje të pastreha, të cilat kanë aplikuar dhe kërkojnë të përfshihen në një nga programet e strehimit social.

Aktualisht janë në bashkinë tonë janë zbatuar disa programe të strehimit social si:

1. Subvencionimi i qirasë në tregun e lirë, ku :

- Gjatë vitit 2019 e kanë përfituar subvencionimin e qirasë 42 familje, të cilat i përkisnin këtyre kategorive: 30 familje PAK, 6 familje me ndihmë ekonomike, 1 viktimë e dhunës në familje, 5 familje gra kryefamiljare.
- Gjatë vitit 2020 kanë përfituar subvencionimin e qirasë 64 familje, të cilat i përkisnin këtyre kategorive : 39 familje PAK, 17 familje me ndihmë ekonomike, 7 familje me gra kryefamiljare, 1 viktimë e dhunës në familje.
- Gjatë vitit 2021 e kanë përfituar subvencionimin e qirasë 22 familje, të cilat i përkisnin këtyre kategorive: 14 familje PAK, 1 familje vajzë - nënë, 3 familje me ndihmë ekonomike, 4 familje me gra kryefamiljare.

2. Subvencionimi i kredive me interesa të lehtësuara, program në të cilin kanë përfituar 16 familje .

3. Banesa me kosto të ulët, pallat i ndërtuar nga Enti Kombëtar I Banesave, ku janë shpallur fituese 40 familje të pastreha të cilat i përkasin kategorive të ndryshme sipas ligjit.

4. Programi për përmirësimin e kushteve të banesave ekzistuese, deri në një ndërtim të ri, në të cilin kanë përfituar 9 familje.

Në rastet kur familjet nuk i plotësojnë kushtet për të përfituar kredi të lehtësuar, sugjerohen të paraqesin kërkesë për tu bërë pjesë e programeve të tjera të strehimit social.

Faleminderit për mirëkuptimin,

Konc.L.Zogu
Konf.A.Shuli
Dosja. _____
Afati _____

